

Njoftim për aplikime për licencim

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë si vijon:

- shoqëria “GREENSOL” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik me, me kapacitet të instaluar 49.96 MW me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam, Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë;
- shoqëria “ASSA ENERGY SOLUTIONS” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga impianti fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 10 MW, vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, Qarku Fier.

Në mbledhjen e datës 05.06.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e secilës prej shoqërive në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me secilën prej kërkesave licencim, brenda 30 (dhjetë) ditëve (nga data 06.06.2026 deri më 06.07.2026), pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.